**URDHËR**
**Nr.1763, datë 28.2.2011**

**MBI MIRATIMIN E DY PROJEKTUDHËZIMEVE TË PROPOZUARA NGA KËSHILLI DREJTUES I AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53 pika 4 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 9, pika 3 të Statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.100, datë 19.12.2000 të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar; të nenit 2 shkronja "c", nenit 11 pika 2 shkronja "ë" dhe nenit 32, të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, nenit 108 pika 1 shkronjat "b" dhe "d" të Kodit të Procedurave Administrative, dhe pasi u njoha me vendimet e Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr.prot.234, datë 1.6.2009 dhe nr.prot.244, datë 25.6.2009,

URDHËROJ:

1. Miratimin e udhëzimit "Mbi marrëdhëniet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave me bankat e siguruara" sipas tekstit të aneksit nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e udhëzimit "Mbi pranimin e bankave në skemën e sigurimit të depozitave dhe certifikimin e tyre" sipas tekstit të aneksit nr.2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Ngarkohen Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe bankat, dhe degët e bankave të huaja për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e udhëzimeve të miratuara me këtë urdhër në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
5. Udhëzimet e miratuara me këtë urdhër hyjnë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATORI
**Ardian Fullani**